

BULETINI

DHJETOR 2023



Ndërsa i japim lamtumirën 2023-ës, ne jemi të ngazëlyer të ndajmë përditësimet më të fundit nga OJQ ACDC që u zhvilluan në muajin dhjetor.

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Ditës Kundër Korrupsionit

Më 6 dhjetor 2023, ACDC, në bashkëpunim me OJQ AKTIV, organizuan diskutimin publik mbi korrupsionin në komunat me shumicë serbe në Kosovë. Gazetarët dhe përfaqësuesit qytetarë, duke përfshirë z. Nenad Radosavljeviq dhe z. Darko Dimitrijeviq, folën për sfidat me të cilat përballen në ekspozimin dhe luftimin e korrupsionit.

Në prag të Ditës së të Drejtave të Njeriut, ACDC dhe AKTIV organizuan debatin mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Panelistët, duke përfshirë z. Sërxfan Sentiq dhe z. Budimir Niçiq, u angazhuan në një diskutim interaktiv për të adresuar sfidat me të cilat përballen komunitetet jo-shumicë, duke promovuar mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.



Përfundimi i trajnimit të aftësive të buta:



Një ceremoni e shpërndarjes së certifikatave u mbajt për të rinjtë që kanë përfunduar me sukses një trajnim tre-mujor për aftësitë e buta. Përmes një sërë ligjëratah dhe ushtrimesh praktike, pjesëmarrësit fituan njohuri në fusha të ndryshme, duke përfshirë aftësitë e komunikimit, menaxhimin e kohës, njohuritë kompjuterike, hartimin e projekteve, planifikimin e biznesit, si dhe mediat sociale dhe marketingun dixhital.

Kjo iniciativë synonte të rriste aftësitë e të rinjve dhe t'u mundësonte atyre të fitojnë njohuri të vlefshme që do t'u sjellin dobi në zhvillimin e tyre profesional. Kjo iniciativë u mbështet nga GIZ.



Projektet e reja

Projekti i Ndërgjegjësimit për gjuhën e urrejtjes:

ACDC është vendosur të ngrisë ndërgjegjësimin për efektet e dëmshme të gjuhës së urrejtjes në forumet publike në mbarë Kosovën, falë financimit nga UNMIK-u dhe mbështetjes nga Divizioni i Programeve për Përfshirje dhe Kundër Diskriminimit të Këshillit të Evropës.



Projekti i pajtimit dhe ndërtimit të besimit:

ACDC, në partneritet me REC, inicon një projekt që nxit pajtimin dhe ndërtimin e besimit ndërmjet studentëve serb dhe shqiptarë të Kosovës në Mitrovicën Veriore dhe Jugore. Në lidhje me këtë, OJQ ACDC dhe OJQ REC kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi. Partneriteti ndërmjet ACDC dhe REC shënon një hap të rëndësishëm përpara në përcjelljen e bashkëpunimit dhe pajtimit të qëndrueshëm ndëretnik, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe përpjekjeve të përbashkëta drejt krijimit të një komuniteti në harmoni dhe më koheziv.



Iniciativa për Bashkëpunim Ndërkulturor


Me qëllim të fuqizimit të grupeve vulnerabël, promovimit të diversitetit ndërkulturor dhe kontributit në përpjekjet e qëndrueshme për ndërtimin e paqes, ACDC filloi projektin me fokus të veçant në komunitetet joshumicë në veri të Kosovës.





Ambasadori austriak në Kosovë, z. Georg Schnetzer dhe zëvendësambasadorja znj. Clarissa Castek u takuan me përfaqësues të ACDC për të diskutuar situatën aktuale politike në veri të Kosovës.

Tekste mbi delikuencën e të miturve në Kosovë dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve



Në faqen tonë janë publikuar dy artikuj (OP-ED) që trajtojnë delikuencën e të miturve në Kosovë dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, veçanërisht në fushën e arsimit. Këta artikuj janë të disponueshëm në gjuhën serbe dhe shqipe.

Fushata për ndihmë juridike falas

Në dhjetor, fushata jonë për ndihmën juridike falas vazhdoi përmes postimeve në mediat sociale, me qëllim të informimit të qytetarëve për ndihmën juridike falas në dispozicion dhe ofrimin e udhëzimeve se si të kërkojnë ndihmë. Këto postime janë pjesë e përpjekjeve tona të vazhdueshme për të fuqizuar dhe edukuar komunitetin rreth qasjes në mbështetje ligjore falas.

Njihen përpjekjet kundër korrupsionit

ACDC merr certifikatë mirënjohjeje nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit për kontributin veçant në promovimin e mandatit të agjencisë brenda komunitetit pakicë në Kosovë gjatë vitit 2023.




Tekste të paraqitura

Ines Aljović Mihajloviq, zyrtare e programit në OJQ ACDC, shkroi tekstin mbi "Rrugën e Mitrovicës drejt Unitetit dhe Prosperitetit". Ajo thekson sfidat me të cilat përballet Mitrovica, me fokus në ndarjen e shkaktuar nga një urë që, në vend që të lidh, ndanë komunitetet. Teksti është publikuar nga OJQ REC.



"Të kujt livadhet, të kujt delet –Çështja e pronës në Kosovë" titullohet teksti i shkruar nga menaxheri i programit të OJQ ACDC, Slobodan Stosic. Në të, ai shpreh shqetësimin për situatën në Kosovë, veçanërisht për çështjen e shpronësimeve dhe të drejtave pronësore. Teksti është botuar në numrin e fundit të Buletinit RG, Konventa Kombëtare për Bashkimin Evropian për Kapitullin 35.



12

ANNIVERSARY

Më 29 dhjetor, ACDC festoi ditëlindjen e saj të 12-të, duke reflektuar mbi një dekadë të kontributit aktiv për një shoqëri gjithëpërfshirëse, duke mbështetur vlerat demokratike dhe duke zbatuar më shumë se 120 projekte kushtuar të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe bashkëpunimit ndëretnik në Kosovë.

